



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 432/7 prot.

Tiranë, më 13.05.2026

REKOMANDIM

Nr. 25, datë 13.05.2026

PËR KONTROLLUESIN
“AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”¹ (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore” (në vijim, “Kontrolluesi ose AMP”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 34, datë 09.02.2026 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. AMP është person juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. AMP organizohet në nivel qendror dhe në nivel vendor. Në nivel qendror, përfaqësohet nga Drejtoria e Përgjithshme, si një strukturë me përgjegjësi

¹Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit, të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

administrative, menaxheriale dhe hetimore, si dhe në nivel vendor, përmes drejtorive rajonale, të cilat ushtrojnë veprimtari operacionale dhe administrative.

Bazuar në ligjin nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, AMP ka në objekt të veprimtarisë, mbikëqyrjen e vazhdueshme, të pavarur, objektive dhe transparente të punonjësve të AMP, Policisë së Shtetit, punonjësve të Gardës së Republikës dhe punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në funksion të zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare.

Funksionet kryesore mbikëqyrëse të AMP janë inspektimi i subjekteve të përcaktuara në ligj dhe parandalimi e zbulimi i veprave penale. Për shkak të kësaj veprimtarie, AMP konsiderohet Autoritet Kompetent, në kuptim të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit dhe është përgjegjëse, ndër të tjera, edhe për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në Pjesën III të Ligjit.

Grupi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e një hetimi administrativ gjithëpërfshirës pranë AMP në nivel qendror dhe vendor, ka identifikuar detyrimet dhe përgjegjësitë e strukturave të përfshira në këtë proces, si dhe ka marrë në konsideratë llojin dhe numrin e lartë të të dhënave personale që përpunohen nga strukturat e AMP-së gjatë veprimtarisë.

Për realizimin e një procesi administrativ të plotë dhe të saktë, Zyra e Komisionerit, mbështetur në pikën 1/h, të nenit 82, pikën 1/ç, të nenit 83 të Ligjit, si dhe në objektin e hetimit të Urdhrit 34, datë 09.02.2026 të Komisionerit, e ka shtrirë hetimin administrativ në disa prej drejtorive rajonale të AMP, si drejtoria rajonale e AMP Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë.

2. Kontrolluesi, bazuar në ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë së shtetit, Gardës së republikës dhe agjencisë së mbikëqyrjes policore në ministrinë e brendshme”, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre, legjitimohet të përpunojë të dhëna personale për kategoritë: “subjekte vlerësimi”, “persona të lidhur”, “persona të tjerë të lidhur”, “punonjës” dhe “vizitorë”.

Gjithashtu, konstatohet se, AMP, në funksion të veprimtarisë së saj, përpunon të dhëna personale e sensitive, sipas kategorive: “Emër”, “Atësia”, “Mbiemër”, “Data e lindjes”, “Nr. i identifikimit”, “Gjinia”, “Vendlindja”, “Shtetësia”, “Adresa”, “Statusi civil”, “E-mail”, “Numër telefoni”, “Arsimi”, “Foto”, “Kartela shëndetësore”, “Analiza gjaku”, “Gjendja psiko-fizike”, “Gjendja penale”, “Të dhëna biometrike” “Sekrecione biologjike”, “Ekzaminimi poligrafik”, etj.

Përpunimi i këtyre të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike, sipas strukturave përkatëse.

3. Nga komunikimet dhe verifikimet e realizuara në terren nga grupi i hetimit administrativ, me përfaqësuesit e AMP, si dhe me përfaqësuesit e secilës drejtori, rezultoi se:

- **Drejtoria e Hetimit**, në përmbushje të përgjegjësi që përcaktohen në ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore” kryen veprimtari informative, gjurmuese/parandaluese, procedurale hetimore dhe administrative. Gjatë ushtrimit të këtyre veprimtarive, administrohet dokumentacion, fakte apo rrethana në përbërje të cilave përpunohen të dhëna personale, të listuara si vijon:

Veprimtaria Informativo-gjurmuese ose parandaluese ka për qëllim përgatitjen e ndjekjes penale për subjektet/strukturat që monitoron AMP. Kjo veprimtari është “sekret” dhe si e tillë, i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 10/2023 “Për Informacionin e Klasifikuar” dhe trajtohen si të tilla nga momenti i administrimit, deri në arkivim apo asgjësim, duke pasqyruar çdo veprim administrimi në regjistrat përkatës të kartotekës së drejtorisë së përgjithshme të AMP-së.

Veprimtaria procedurale-penale ka si qëllim marrjen e dënjësive mbi veprat penale, parandalimin e pasojave të mëtejshme, identifikimin e autorëve dhe dokumentimin e plotë të fakteve për zbardhjen e së vërtetës, në lidhje me vepra penale të kryera nga subjektet që monitoron AMP, gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj. Gjatë kësaj veprimtarie, administrohen dokumentacion, fakte apo rrethana që përmbajnë të dhëna personale. Këto të dhëna përpunohen dhe pasqyrohen në akte procedurale, të cilat janë pjesë përbërëse të fashikullit të hetimit dhe i referohen prokurorisë kompetente. Aktet procedurale hartohen në një kopje të vetme dhe nuk ruhen në kartotekën apo arkivat e AMP, por depozitohen dhe administrohen ekskluzivisht nga prokuroria, si autoriteti përgjegjës për disponimin dhe administrimin e tyre.

Veprimtaria Administrative e kryer nga Drejtoria e Hetimit, zhvillohet kryesisht në rastet kur, nga vlerësimi paraprak, nuk rezultoi qartë se kemi të bëjmë me një veprë penale, por ekziston nevoja për verifikime të mëtejshme për të përcaktuar natyrën e rastit. Specialisti përgjegjës për trajtimin e çështjes hap një numër unik në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve, ku ka akses të dedikuar, dhe regjistron në mënyrë të plotë të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë trajtimit të saj, përfshirë edhe të dhënat personale të nevojshme për këtë proces.

Në rastet kur procedohet me hetim penal ose proces informativ, ndiqen procedurat përkatëse të parashikuara më sipër. Ndërsa kur çështja trajtohet vetëm në kuadër të një veprimtarie administrative, pas njoftimit të ankuesit mbi përfundimin e saj, dokumentacioni përkatës, përfshirë edhe të dhënat personale, arkivohet në sekretarinë e AMP, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi për administrimin e arkivave.

Në përfundim të procesit, çështja mund të rezultojë në fillimin e një hetimi penal, sugjerimin e një mase disiplinore ose arkivimi i praktikës kur konstatohet se pretendimet e parashtruara nuk qëndrojnë.

- **Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave**, përpunon të dhënat personale që merren nga sistemet e Policisë, si dhe të dhënat që ka në dispozicion vetë AMP, si Sistemi i Menaxhimit dhe Trajtimit të Ankesave. Të dhënat që merren prej saj, janë: emri, mbiemri dhe pozicioni i punës. Këto të dhëna pasi verifikohen dhe analizohen, konkludohet në mënyrë të përmbledhur, në përputhje me kompetencat ligjore. Për të dhëna të tjera të nevojshme sipas rastit, kategorisë së tyre dhe përmbajtjes vepohet nëpërmjet kartotekës ose nëpërmjet sekretarisë.
- **Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar/Periodik** ushtron veprimtari të strukturuar administrative dhe procedurale në kuadër të rivlerësimit të punonjësve të strukturave të sigurisë, si Policia e Shtetit, Garda e Republikës dhe AMP, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Kjo veprimtari ushtrohet nga drejtoria duke organizuar procesin e përzgjedhjes së trupave vlerësuese përmes shortit, administruar dhe verifikuar formularët e deklaramit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe duke zbatuar standarde të unifikuara për kontrollin e trefishtë të subjekteve të vlerësimit. Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar/Periodik, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, përpunon disa kategori të dhënash personale, të cilat janë thelbësore për realizimin e procesit të rivlerësimit. Konkretisht, përpunohen **të dhëna identifikuese** që përfshijnë gjeneralitetet e subjektit si: emri, mbiemri, numri i identifikimit, vendbanimi, pozicioni i punës; **të dhëna financiare dhe pasurore** që përfshijnë deklaramet mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, burimet e krijimit të tyre, të ardhurat, interesat financiare, detyrimet dhe marrëdhëniet ekonomike brenda dhe jashtë vendit; **të dhëna që lidhen me integritetin dhe figurën e subjektit**, si: informacione mbi gjendjen penale, verifikime të figurës, kontakte apo rrethana që mund të cenojnë besueshmërinë dhe integritetin profesional; **të dhëna profesionale** që përfshijnë nivelin arsimor, trajnimet, historikun e punësimit, performancën në detyrë, vlerësimet periodike dhe aftësitë profesionale; **si dhe të dhëna me personat e lidhur/personat e tjerë të lidhur**, ku përfshihen familjarët apo subjekte të tjera të lidhura ekonomikisht apo juridikisht me subjektin e vlerësimit, për të cilët përpunohen të dhëna identifikuese dhe pasurore në funksion të verifikimit të plotë të burimeve financiare dhe interesave.

Këto kategori të dhënash përpunohen në mënyrë të strukturuar, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë, garantimin e transparencës dhe marrjen e vendimeve administrative.

- **Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**, përpunon të dhëna personale të punonjësve dhe të dhëna për aplikantët që konkurojnë për t'u punësuar në AMP. Këto të dhëna personale administrohen në dosje fizike dhe në formatin "excel". Ndër kategoritë e të dhënave personale të nevojshme për

përpunim lidhur me punonjësit e AMP, janë gjurmët daktiloskopike dhe mostra e ADN-së. Ky përpunim kryhet në zbatim të nenit 58 të ligjit nr. 128/2021 “*Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore*” dhe administrohen sipas bazave të të dhënave që disponon Policia Shkencore.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me këto kategori të të dhënave personale, konstatohet se nuk janë parashikuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e administrimit dhe përpunimit të tyre, transferueshmërinë, sigurinë, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., sipas parashikimeve të nenit 28 dhe 66 të Ligjit.

Në këtë kuadër, Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa shtesë të sigurisë së përpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenet 28 dhe 66 të Ligjit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive, e sidomos të dhënave biometrike, gjenetike dhe atyre të lidhura me shëndetin. Mungesa e rregullimit të qartë për këto kategori të dhënash përbën cenim për përpunimin e ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme, Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla dhe procedura organizative specifike për këtë kategori të të dhënave personale, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenin 28 dhe 66 të Ligjit.

4. Kontrolluesi ka vënë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, urdhrin nr. 195, datë 23.02.2020 “*Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale nga trupa e vlerësimit*”. Në nenet 7, 8 dhe 9 të saj, parashikohet se aksesi në të dhëna personale bëhet nga punonjësit e Kontrolluesit duke specifikuar në mënyrë të qartë rolet dhe detyrat e tyre, me qëllim garantimin e aksesit të autorizuar.

Grupi i hetimit administrativ, konstaton se, në rregullore nuk janë specifikuar kategoritë e të dhënave personale sipas subjekteve përkatëse, të drejtat që gëzojnë subjektet e të dhënave, si dhe nivelet e aksesit në të dhënat personale të punonjësve të drejtorisë së përgjithshme dhe drejtorive rajonale të AMP, në përputhje me proceset përpunuese të cilat kryejnë, si disa nga masat teknike e organizative që duhet të ndërmarrë Kontrolluesi për të garantuar sigurinë e përpunimit dhe për të mbrojtur të dhënat personale nga aksesi i paautorizuar, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 6, si dhe neneve 28 dhe 66 të Ligjit.

Për më tepër, nga shqyrtimi i rregullores së miratuar “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, si dhe nga analizimi i akteve të tjera rregullatore dhe dokumentacionit shtesë të vendosur në dispozicion nga Kontrolluesi, konstatohet se në asnjë dispozitë të tyre nuk janë përcaktuar afate të qarta dhe konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale.

Mungesa e përcaktimit të afateve, vërehet si një parregullsi, pasi përcaktimi i kohës së ruajtjes së të dhënave personale është një nga parimet thelbësore të mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo tregon, gjithashtu, mungesë në zbatimin praktik të procedurave të asgjësimit të të dhënave, të cilat janë po aq të rëndësishme sa vetë ruajtja e tyre, në mënyrë që të parandalohen rreziqet e ruajtjes përtej afatit, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, të parashikuar në pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, i cili kërkon që të dhënat personale të ruhen vetëm për periudhën kohore që është e nevojshme për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur dhe përpunuar.

Nga hetimi administrativ i ushtruar konstatohet se, të dhënat sensitive (të dhënat e lidhura me shëndetin/biometrike/penale) të subjekteve të të dhënave që përpunohen nga Kontrolluesi, nuk identifikohen në aktet rregullatore të Kontrolluesit, si dhe për këtë kategori të të dhënave personale nuk janë parashikuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit të tyre, sigurinë, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., sipas parashikimeve të nenit 28 dhe 66 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm hartimi dhe rishikimi i rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën duhet të parashikohen rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave personale, konfidencialitetin, aksesin, afatet e mbajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave të përpunuara manualisht dhe elektronikisht, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj., për të gjithë strukturat dhe drejtoritë e AMP, në përputhje me parashikimet e neneve 28 dhe 66 të Ligjit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete për ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale të përpunuara manualisht dhe elektronikisht, në kundërshtim me parimin e kufizimit të ruajtjes së kohë, sanksionuar në pikën 5, të nenit 6, pikës 2, të nenit 48 të Ligjit, si dhe nenit 12 të Udhëzimit nr. 5, datë 16.07.2025 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente*” (në vijim “*Udhëzimi nr. 5*”). Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar.

Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit. Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

Në këtë kuadër, Kontrolluesi është i detyruar të sigurojë zbatimin e masave shtesë për garantimin e sigurisë gjatë përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me nenet

28 dhe 66 të Ligjit, duke kushtuar kujdes të veçantë ndaj kategorive sensitive, në veçanti të dhënave penale, biometrike dhe atyre që lidhen me shëndetin. Mungesa e një kuadri të qartë rregullator për këto kategori të të dhënave, përbën një pengesë për realizimin e një përpunimi të ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

Për shkak të natyrës së ndjeshme të këtyre të dhënave, Kontrolluesi duhet të hartojë dhe të zbatojë politika dhe procedura të posaçme organizative, të cilat përcaktojnë në mënyrë të detajuar mënyrat e përpunimit dhe masat përkatëse të sigurisë, në përputhje me nenet 28 dhe 66 të Ligjit.

5. Përfaqësuesit e Kontrolluesit kanë deklaruar përmes e-mailit të datës 03.03.2026 se të gjitha strukturat e AMP-së administrojnë dhe përdorin sisteme të ndryshme në funksion të veprimtarisë së tyre. Disa prej sistemeve elektronike në përdorim të AMP, janë të klasifikuara. Për sa i përket sistemeve të paklasifikuara dhe të dhënave personale në përmbajtje të tyre, konstatohet, si vijon:

Kontrolluesi deklaron se ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, një sistem i krijuar nga AMP, i cili gjeneron të dhëna personale dhe statistikore në të gjitha fazat e trajtimit të ankesave.

Konkretisht, ky sistem popullohet me të dhënat personale të tilla si: emri, mbiemri, datëlindja, adresa. Këto të dhëna aksesohen dhe menaxhohen nga punonjësit e njësisë përkatëse të trajtimit të ankesave pranë drejtorisë së përgjithshme, si dhe nga punonjësit e autorizuar pranë drejtorive rajonale vetëm në ato raste kur i është deleguar për trajtim rasti, në përputhje me funksionet përkatëse.

Në vijim, Kontrolluesi deklaron se rregullat dhe procedurat për përdorimin dhe shfrytëzimin e sistemeve janë të përcaktuara në Manualët për Përdorimin e tyre dhe Procedurat Standarde të Punës të miratuara me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë. Në këto dokumente janë përcaktuar qartë afatet e ruajtjes, korrigjimit apo fshirjes së të dhënave personale bazuar në legjislacionin për Informacion e Klasifikuar dhe Udhëzimet e Ministrisë të Brendshme për veprimtarinë parandaluese/inteligjente të strukturave të AMP.

Lidhur me sa deklarohet më sipër, konstatohet se AMP nuk ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ akte rregullatore mbi mënyrën e implementimit, regjistrimit, administrimit të të dhënave, rolet, aksesin e punonjësve dhe funksionimin e sistemeve elektronike të paklasifikuara, në kundërshtim me nenet 27, 61 dhe pikën 3, të nenit 66 të Ligjit.

Gjithashtu, AMP nuk ka mundur të dokumentojnë veprimtaritë e përpunimit dhe marrjen e masave të sigurisë, përfshirë politikat e përdorimit të profilizimit, në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit dhe pikën 3, të nenit 10 të Udhëzimit nr. 5 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, AMP duhet të marrë masa të menjëhershme për hartimin, miratimin dhe zbatimin e akteve rregullatore të detajuara që përcaktojnë mënyrën e implementimit, regjistrimit dhe administrimit të të dhënave personale në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave duke përfshirë qartë rolet, nivelet e aksesit dhe përgjegjësitë e punonjësve, në përputhje me kërkesat e nenit 27, 61 dhe pikës 3, të nenit 66 të Ligjit.

6. AMP, në drejtorinë e përgjithshme, ka të instaluar sistemin e video survejimit CCTV, përmes së cilit kryejnë mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtrojnë veprimtarinë, për qëllim të mbrojtjes së pronës, sigurisë dhe kontrollit mbi hyrjet dhe daljet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me nenin 66 të Ligjit dhe me parashikimet e Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejimit” (në vijim “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi është i detyruar të hartojë rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në përputhje me parashikimet e nenit 66 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

7. Konstatohet se Kontrolluesi disponon faqe zyrtare web <https://www.amp.gov.al/>.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, AMP nuk ka hartuar dhe publikuar “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të internetit <https://www.amp.gov.al/>, duke mos përmbushur kështu detyrimin ligjor për të garantuar transparencën dhe informimin e subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në të.

Mospërmbushja e këtij detyrimi bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit, i cili përcakton se çdo subjekt i të dhënave duhet të informohet në mënyrë të qartë dhe të plotë për qëllimin e mbledhjes dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave të tij personale, kategoritë e të dhënave personale, personat që do t’i përpunojnë apo përfitojnë akses në këto të dhëna, afatet e ruajtjes së tyre, si dhe për të drejtat që ai gëzon sipas legjislacionit përkatës, përfshirë të drejtën për akses, korrigjim, kundërshtim dhe fshirje.

Mungesa e politikave të qarta të privatësisë cenon parimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale dhe rrit rrezikun për shkelje të privatësisë dhe të drejtave themelore të individëve. Subjektet që aksesojnë faqen ose ngarkojnë të dhëna personale në të nuk informohen as për masat teknike dhe organizative të sigurisë që aplikohen për mbrojtjen e të dhënave, duke krijuar një boshllëk të rëndësishëm në respektimin e standardeve ligjore dhe etike për mbrojtjen e privatësisë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket mbrojtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 13 të Ligjit, duhet të aplikohet dhe garantohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave që kryen Kontrolluesi.

8. Kontrolluesi deklaron se për disa nga sistemet që disponon janë të zhvilluara nga palë të treta nëpërmjet kontratave me këto subjekte.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ asnjë kontratë me palë të treta, lidhur me sistemet elektronike që disponon, që provon krijimin ose mirëmbajtjen e tyre nga kompani të jashtme.

Grupi i hetimit administrativ konstaton se, për proceset përpunuese të cilat ofrohen nga palë të treta për AMP, duhet të përcaktohen të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”, i ndryshuar (në vijim “*Udhëzimi nr. 19*”).

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi, që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë përpunimi e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë kontrolluesi dhe përpunuesi për të siguruar e garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, duke reflektuar rolet, detyrimet dhe përgjegjësitë mes kontrolluesit dhe përpunuesit, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

9. Gjithashtu, konstatohet se, strukturat e AMP-së nuk kanë marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e germave “c” dhe “ç”, të nenit 34 të Ligjit dhe pikës 2, të nenit 5, të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në germat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 34 të Ligjit si dhe pikës 2, të nenit 5, të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të pjesëmarrjes dhe organizimit të trajnimeve të dedikuara për punonjësit që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitohet pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi, nëpërmjet shkresës me nr. 1861/5 prot., datë 24.04.2026, administruar me tonën me nr. 432/6 prot., datë 24.04.2026, ka shprehur angazhimin për marrjen e masave lidhur me përmbushjen e disa prej gjetjeve të konstatuara nga grupi i hetimit administrativ. Në lidhje me disa prej konstatimeve të dërguara, Kontrolluesi ka paraqitur pretendimet shkresore, si vijon:

- Lidhur me gjetjen e grupit të hetimit administrativ mbi rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, AMP ka dërguar observacionin e saj, për të cilin deklaron se lidhur me veprimtarinë që ushtron Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar/Periodik ka një paketë të plotë ligjore, që parashikon dhe rregulla për të dhënat personale.

Fillimisht, theksojmë se në konstatimet përkatëse të grupit të hetimit administrativ janë cituar dhe shqyrtuar aktet ligjore e nënligjore të vendosura në dispozicion, duke parashikuar, sipas rastit të dhënat personale që përpunohen.

Së dyti, pas analizimit të akteve rregullatore, si dhe pretendimeve të dërguara, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në to, nuk janë specifikuar kategoritë e të dhënave personale sipas subjekteve përkatëse, të drejtat që gëzojnë subjektet e të dhënave, si

dhe nivelet e aksesit në të dhënat personale të punonjësve të drejtorisë së përgjithshme dhe drejtorive rajonale të AMP, në përputhje me proceset përpunuese të cilat kryejnë, si disa nga masat teknike e organizative që duhet të ndërmerret Kontrolluesi për të garantuar sigurinë e përpunimit dhe për të mbrojtur të dhënat personale nga aksesit i paautorizuar, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 6, si dhe neneve 28 dhe 66 të Ligjit.

Për më tepër, nga dokumentacionit i vendosur në dispozicion nga Kontrolluesi, rezulton se për të dhënat sensitive (të dhënat e lidhura me shëndetin/biometrike/penale) të subjekteve të të dhënave që përpunohen nga Kontrolluesi, nuk identifikohen në aktet rregullatore, si dhe për këtë kategori të të dhënave personale nuk janë parashikuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit të tyre, sigurinë, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., sipas parashikimeve të nenit 28 dhe 66 të Ligjit.

Për të gjitha konstatimet sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën duhet të parashikohen rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave personale, konfidencialitetin, aksesin, afatet e mbajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave të përpunuara manualisht dhe elektronikisht, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj., sipas parashikimeve të nenit 28 dhe 66 të Ligjit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, rishikimi i akteve rregullatore nuk duhet të kufizohet vetëm në Drejtorinë e Vlerësimit Kalimtar/Periodik, por duhet të përfshijë të gjitha strukturat dhe drejtoritë e AMP-së, të cilat në ushtrimin e funksioneve të tyre përpunojnë të dhëna personale. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse është e domosdoshme për të garantuar standarde të njëjta mbrojtjeje, për të shmangur boshllëqet rregullatore dhe për të siguruar përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kuadër, rishikimi i rregullores mbetet i nevojshëm për të adresuar mangësitë e konstatuara dhe për të vendosur rregulla të qarta dhe të detajuara për të gjitha aspektet e përpunimit të të dhënave personale, në nivel institucional, për garantimin e sigurisë gjatë përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me nenet 28 dhe 66 të Ligjit, duke kushtuar kujdes të veçantë ndaj kategorive sensitive.

- Lidhur me konstatimin e grupit të hetimit administrativ mbi Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion:
 - *Urdhër nr. 57, datë 06.07.2020 “Për miratimin e procedurës standarde për pranimin, administrimin dhe hetimin administrativ të ankesave në shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”*
 - *Urdhër nr. 56, datë 06.07.2020 “Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Ankesave dhe Hetimit”*

- *Udhëzues për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Ankesave*

Pas analizimit të akteve të sipërcituara, Zyra e Komisionerit vlerëson se, AMP ka vendosur në dispozicion aktin e implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Ankesave. Megjithatë, në aktet rregullatore të dërguara, rezulton se, nuk janë hartuar/parashikuar/dokumentuar rregulla për përpunimin e të dhënave personale dhe masat konkrete teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së përpunimit, duke përfshirë profilizimin, enkriptimin, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve gjatë aksesit të tyre në sistem, në kundërshtim me nenet 27, 61 dhe pikën 3, të nenit 66 të Ligjit, si dhe pikën 3, të nenit 10 të Udhëzimit nr. 5 të Komisionerit.

- Në pretendimet me shkrim, rezulton se, Kontrolluesi pranon gjetjet e grupit të hetimit administrativ lidhur me hartimin dhe publikimin e politikave të privatësisë, si dhe deklarën se këto të fundit janë përmbushur duke i implementuar në faqen zyrtare web të AMP-së.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi nga këqyrja e faqes zyrtare të internetit <https://www.amp.gov.al/> më datë 29.04.2026, (pesë ditë pas deklarimit të dërguar përmes shkresës me nr. 1861/5 prot., datë 24.04.2026), nuk rezulton që ky detyrim të jetë përmbushur.

- Lidhur me kontratat e dërguara për shërbimet me palë të treta, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në to, nuk parashikohet asnjë dispozitë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe nuk janë reflektuar rolet mes palëve si kontrollues dhe përpunues të të dhënave personale, përfshirë detyrimet e përgjegjësitë që secila palë duhet të ketë gjatë procesit të përpunimit të të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 26 të Ligjit dhe dispozitat e Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

Në kontrata përpunimi, përcaktimi i roleve mes kontrolluesit dhe përpunuesit të të dhënave personale dhe garancive minimale që duhet të përmbajë kjo marrëveshje, është i domosdoshëm, në mënyrë që të garantohet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 13, 26, 27, 28, 34, 48, 61, 66, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, si dhe të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të

gjitha proceset e përpunimit, duke përfshirë edhe ato përmes sistemit të video survejimit CCTV, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;

2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të rishikojë rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave sensitive, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
3. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave apo politikave, për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, lloji dhe specifikimet e kamerave, vendosja e tyre në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren, si dhe përcaktimin e saktë të zonave që do të jenë nën mbikëqyrje etj., sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi të marrë masa për dokumentimin e të gjitha veprimtarive të përpunimit të të dhënave personale, si dhe gjatë përdorimit të sistemeve, duke përfshirë politikat e sigurisë, masat teknike dhe organizative të zbatuara, si dhe rregullat mbi përdorimin e profilizimit, në mënyrë që të garantohet transparenca, llogaridhënia dhe përputhshmëria, sipas parashikimeve të nenit 61 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 5 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, të marrë masa për të publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://www.amp.gov.al/>, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, të përfshijë në kontratë dhe/ose aneks kontratë, të nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit, detyrimet për përcaktimin e rregullave specifike në lidhje me marrëdhënien mes palëve, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në germat “c” dhe “ç” të nenit 34 të Ligjit, lidhur me trajnimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave, si dhe punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre.
8. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

- (i) vazhdimisht, detyrimin e treguar në pikën 7 më sipër;
- (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1, 5 dhe 6 më sipër;
- (iii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 2, 3 dhe 4 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
10. Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 13.05.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi